

REPUBLIKA E KOSOVËS, REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO Qeveria e Kosovës / Vlada Kosova / Government of Kosovo Ministria e Financave / Ministarstvo za Finansije Ministry of Finance Arkiva - Arhiva - Archive	
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit:	01/KMLVPP
Nr. Prot. Prot. No.:	1625
Nr. i faqeve Broj stranica No. pages:	22,09,2020
Dalëse	PRISHTINË/A



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave
Ministarstvo za Finansije - Ministry of Finance

Numër: 02/2020
Datë: 21.09.2020

Në mbështetje të vendimit Nr. 92/2020, datë 10.09.2020 Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve për Pronat e Paluajtshme në takimin e mbajtur me datë 18.09.2020, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Vazhdohet deri më 31 dhjetor 2020 afati i licencave të vlerësuesve të pronave të paluajtshme të cilat kanë skaduar gjatë vitit 2020.
 - 1.2. Vlerësuesit të cilit i ka skaduar licenca gjatë vitit 2020, duhet të dorëzoj pranë Sekretarisë të angazhuar nga Këshilli Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme (KMLVPP) në Odën Ekonomike të Kosovës (vendimi Nr. 01/2020, datë 21.09.2020 i KMLVPP), aplikacionin për vazhdimin e licencës si dhe vetë-deklarimin që i njëjti nuk është në procedura gjyqësore aktualisht dhe nuk është i dënuar në të kaluarën për vepra penale të ndërlidhura me fushëveprimtarinë përkatëse.
2. Vlerësuesi i licencuar i cili ka kërkuar vazhdimin e licencës, me rastin e aprovimit do të pajiset me dokumentin përkatës nga KMLVPP përmes të cilit dëshmon validitetin e licencës deri më datën sipas pikës një (1) të këtij vendimi.
3. Gjatë kësaj periudhe nuk do të trajtohen kërkesat për ngritjen e shkallës së licencës nga shkalla I në IA për çfarë duhet të njoftohen aplikuesit me rastin e dorëzimit të kërkesës së tyre.
4. Sekretaria e përkohshme e angazhuar KMLVPP obligohet që të përgatit formën e dokumentit për ti pajisur personat e licencuar si vlerësues me rastin e vazhdimin të validitetit të licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi dhe formën e njoftimit për aplikuesit për ngritjen e shkallës së licencës.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.

ARSYETIM

Bazuar në ndryshimet e ndodhura pas shfuqizimit të vendimeve për themelimin e Bordit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme sipas Vendimit nr. 61/2020 dhe caktimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës për Licencimin e Vlerësuesve të Pronave të Paluajtshme me Vendimin e MF nr. 92/2020, sipas nenit 17, paragrafi 4 dhe 5, të Ligjit Nr. 06/L-005 për Tatimin në Pronën e Paluajtshme.

Deri në funksionalizimin e plotë të Këshillit të ri në funksion të adresimit të kërkesave në proces për shkak të nevojës së kalimit përmes fazës së tranzicionit nga organizimi dhe funksionimi i deritashëm në organizimin e ri, si dhe për të siguruar që vlerësuesit e licensuar të mos ballafaqohen me vështirësi në vazhdimin e veprimtarisë së tyre, dhe duke marr parasysh kërkesat e shumta të dorëzuara për vazhdim të licencave dhe ngritjes së shkallës së licencës, KMLVPP ka vendosur sipas dispozitivit të këtij vendimi.

Vendimi i'u dërgohet:

Anëtarëve të Këshillit;

Sekretarisë së Këshillit; dhe

Arkivit të MF-së;

Agron THAÇI

Kryesues i Këshillit

